



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
SP-038
Prishtinë, më 9 dhe 12 korrik 2018

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR
MË 9 DHE 12 KORRIK 2018**

Seancën e kryesoi z. Kadri Veseli, kryetari i Kuvendit, i ndihmuar nga z. Xhavit Haliti, nënkryetari i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të caktuar me vendim të Kuvendit, në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më 28 qershor 2018.

Kryetari procedoi me pikën e vetme të rendit të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit i ka rekomanduar mos miratimin e tij.

Ai e ftoi ministrin e Drejtësisë, z. Abelard Tahiri, ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Drejtësisë, z. Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit, si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë.

Lidhur me Projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit diskutuan: Albulena Haxhiu, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe në emër të GP të LVV-së; Korab Sejdiu, në emër të GP të LDK-së; Hajdar Beqa, në emër të GP të PDK-së; Frashër Krasniqi, në emër të GP të PSD-së; Shkumbin Demaliaj, në emër të GP të AAK-së, Bilall Sherifi, në të GP Nisma Socialdemokrate; Albert Kinolli, në emër të GP “6+”, Armend Zemaj, Nezir Çoçaj, Sami Kurteshi, Memli Krasniqi, Milaim Zeka, Igor Simiq dhe ministri Abelard Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në fund të diskutimeve, kryesuesi konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje dhe votimi i këtij projektligji shtyhet.

* * *

Vazhdimi i seancës plenare më 12 korrik 2018

Kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 46
Kundër ----- 14
Abstenuan ----- 6

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare më 12 korrik, në orën 15:00.

Kryetari i Kuvendit:
KADRI VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*